**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA TREGTARE**
**UNITED TRANSPORT (UNI TRANS) SHPK**
**TIRANE**

---

**VENDIM DATE 12.09.2019**
**I ORTAKUT TE VETEM TË SHOQERISE TREGTARE**
**UNITED TRANSPORT (UNI TRANS) SHPK**

Në Tirane, sot në datën 12, muaji Shtator, viti 2019, u mblodh Ortaku i Vetem i Shoqërisë Tregtare "UNITED TRANSPORT (UNI TRANS)" SHPK Tirane , në selinë e saj, për shqyrtimin e rendit të ditës:

a. Shqyrtimin e veprimtarisë tregtare dhe treguesve financiarë të Shoqërisë Tregtare "UNITED TRANSPORT (UNI TRANS)" SHPK Tirane, për vitin ushtrimor ne vazhdim 2019 si dhe ecuria e saj në të ardhmen;
b. Shqyrtimin e projektit te bashkimit (perthithjes) me shoqerite tregtare "ALBANIAN COURIER" SHPK Tirane, ku shoqeria tregtare "UNITED TRANSPORT (UNI TRANS)" SHPK Tirane eshte perthithesja dhe shoqeria "ALBANIAN COURIER" SHPK Tirane eshte e perthithura;
c. Caktimin e Ekspertit Kontabel te Rregjistruar per te kryere aktin e ekspertimit per bashkimin e shoqerive.
d. Miratimin e Projekt Marreveshjes per bashkimin me perthithje.
e. Te autorizoje administratorin e shoqerise z.Dorian Vezuli per te perfaqesuar shoqerine per procesin e bashkimit me perthithje.

Ortaku i Vetem, pasi u njoh me rendin e ditës;

**V Ë R E N SE**

Shoqeria "UNITED TRANSPORT (UNI TRANS" SHPK Tirane, me seli ne Tirane, Njesia Bashkiake nr. 11, rruga Dritan Hoxha, Godina – 5 kateshe, perballe Pallatit Asllan Rusi, eshte regjistruar si person juridik me date 15.09.2007, prane Qendres Kombetare te Biznesit (Q.K.B), me numer identifikimi NIPT-i K51524005I.

Ne baze te aktit te themelimit dhe te statutit, kjo shoqeri eshte krijuar nga Ortaku i Vetem shoqeria Arch Investor, me kapital 100,000 (Njeqindmije) leke, te ndara ne 100 (njeqind) pjese kapitali (kuota) me vlere nominale 1,000 (njemije) leke per kuote, te zoteruara 100 % nga Ortaku i Vetem shoqeria Arch Investor, me perfaqesues ligjor z. Dorian VEZULI dhe zj.Klarida LEKA.
Gjatë shqyrtimit të veprimtarisë tregtare dhe treguesve financiarë të Shoqërisë Tregtare "UNITED TRANSPORT (UNI TRANS)" SHPK Tirane, Ortaku i Vetem konstaton se për permiresime qe rrjedhin nga perdorimi i te njejtave asete pune dhe nga ngushtimi i ndjeshem i hapesirave te punes, te behet bashkimi i kësaj shoqërie me shoqerine "ALBANIAN COURIER" SHPK Tirane, nepermjet metodes se perthithjes, ku baza e nisjes per bashkimin do te jene treguesit e Pasqyrave Financiare te dates 31.12.2018, si dhe Pasqyrat Financiare te ndermjetme te mbyllura me 31 Gusht 2019, ndersa aktiviteti i vitit 2019 do te konsiderohet i perbashket.

Për këto arsye, Ortaku i Vetem i Shoqërisë tregtare "UNITED TRANSPORT (UNI TRANS)" SHPK Tirane, pas shqyrtimit te rendit te dites;

**V E N D O S I :**

- Te pranoje bashkimin e shoqerive tregtare "ALBANIAN COURIER" SHPK Tirane me shoqerine "UNITED TRANSPORT (UNI TRANS)" SHPK Tirane, nepermjet formes se

perthithjes, mbi bazen e te dhenave te Pasqyrave Financiare te dates 31 Dhjetor 2018 si dhe te Pasqyrave Financiare te ndermjetme te mbyllura me 31 Gusht 2019;

- Caktimin e z.Lavdimir FUSHA "Ekspert Kontabel i Rregjistruar", anetar i Institutit te Eksperteve Kontabel te Regjistruar – I.E.K.A me license Nr. 97, date 10.01.2001, per kryerjen e aktit te ekspertimit ne llogaritjen e raportit te ortakeve ne kapitalin themeltar duke u nisur nga raporti i ortakeve ne kapitalin neto te shoqerise "UNITED TRANSPORT (UNI TRANS)" SHPK Tirane, pas bashkimit ;
- Miratimin e Projekt Marreveshjes per bashkimin me perthithje;
- Te autorizoje administratorin e shoqerise z.Dorian Vezuli dhe ti jap tager te plote per te perfaqesuar shoqerine ne procesin e bashkimit (te nenshkruaje Projekt-Mareveshjen e perthithjes dhe cdo dokument tjeter te nevojshem ne zbatim te ketij vendimi).
- Depozitimin e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare te Biznesit - QKB.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË TREGTARE**

"UNITED TRANSPORT (UNI TRANS)" SHPK TIRANE

**ARCH INVESTOR SHPK**

**Niko Leka**

ARCH INVESTOR
Tirana Albania

UNITED TRANSPORT
sh.p.k.
TIRANA - ALBANIA